

Tiranë, më 17.07.2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës – Shërbim

**PËR
ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Zhvendosja e pajisjes Kappa të prodhuesit Comerco/ose ekuivalent”, për një periudhë 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Shërbimet e zhvendosjes 98392000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

I.1 Fondi Limit për këtë procedurë prokurimi është **2,208,333** (dy milion e dyqind e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH dhe 2,650,000** (dy milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) **lekë me TVSH.**

I.2 Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ***Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane*** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizimin nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për tregtim të pajisjeve mjekësore.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 77 te Ligjin nr. 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Gjithashtu ky kriter eshte bazuar dhe ne nenin 21, 22 dhe 23 te Ligjit Nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore“.*

b. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë ***Certifikaten ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ISO 13485:2016 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”***, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. **Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.**

Argumentimi: Ky kriter i percaktuar ne piken a) dhe b)eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, ne te cilen gjejmë te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktore për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 1 te nenit 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar*

se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”, per aq sa nuk bie ne kundërshtim me LPP 162/2020 ”Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit*** për të cilat konkurron operatori.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, ”Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në nenin 55/4 të VKM 285/2021 ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur të Thjeshtuar, e cila është 40 % e Fondit Limit të kontratës së shpallur. AK është e vetmja qendër terciare në RSH për këtë arsye praktika e vendosur ndër vite e cila ka rezultuar e suksesshme, është ajo e marzheve maksimale të përcaktuara nga legjislatori në Rregullat e Prokurimit Publik si dhe në Legjislacionin e Prokurimit Publik në tërësi.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **sa 20% e vlerës së fondit limit* të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron operatori dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime* të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, së bashku me kontratën përkatëse, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe/ose fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.**

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore,** ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/loteve për të cilin ofertohej, **konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10.**

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me nenin 40, pika 5/ b) dhe c) të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

b) Operatori Ekonomik duhet të vërtetohet që ka të paktën **2(dy)* Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vet të çertifikuar për çistalim, zhvendosje dhe instalime, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës.

***Shënim:** *Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Në rastet kur OE do të shpallet fitues duhet të paraqesë dokumentacionin provues sipas këtij kriteri.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të shkresës nr.1124/9 prot., datë 01.07.2024 “Kërkesë për hapje procedure” të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierisë Klinike, bashkëlidhur me shkresën nr. 1124/7 prot., datë 24.05.2024 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve

teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Zhvendosja e pajisjes Kappa të prodhuesit Comercer/ose ekuivalent**”, për një periudhë 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës, për çmontimin dhe magazinimin e pajisjes në Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore në katin -1., dhe shkresa për plotësimin e informacionit me nr.1124/8 prot, date 19.06.2024, **“Zhvendosja e pajisjes Kappa të prodhuesit Comercer/ose ekuivalent”** për një periudhë 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës, për çmontimin dhe magazinimin e Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore në katin -1, me Urdhër të Titullarit të Përgjithshëm me nr. 192 (nr. 1124/2 prot) datë 10.05.2024, u argumentua/hartuar nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetet perkatese ne lidhje me kriteret teknike, si kriter i vendosur ne perputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne nenit 41, të VKM 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohen të gjitha kriteret e mundshme që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Për këtë procedure objekti i prokurimit është: për një periudhë 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës, për çmontimin dhe magazinimin e Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore në katin -1. Ky kriter konkretisht, është vendosur në mënyrë që e gjithë procedura të bëhet nga persona të kualifikuar të cilët garantojnë zbatimin e kontratës plotësisht dhe në mënyrën e duhur, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj. Ky kriter është miratuar dhe vendosur nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me Kërkesat për kualifikim, në përpjesëtim me Nenin 77 pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”,.Ky kriter mbeshtetet edhe ne Rekomandimin e APP Nr. 8197, date 03.09.2018 Prot “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit mallra, pune, sherbime”.Ky kriter gjen mbeshtetje ne VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” te nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, piken 4, ku percaktohet se: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a)licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose, b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose, c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose, ç)mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

c)OE duhet të paraqesë Autodeklarate ku garanton se në rast të shpalljes fitues, pajisjet që do të çistalohen, zhvendosjen dhe instalohen, të gjitha punimet do të bëhen në përpjesëtim me specifikimet teknike të përcaktuar në DST, si dhe këto pajisje duhet të jenë në gjendje të plotë në momentin e dorëzimeve të punimeve.

Argumentimi: Kriteret e vendosura ne DST ne pikat d) jane vendosur nga anetaret e NjP qe kane specialitet perkatese ne lidhje me kriteret teknike si dhe eshte ne perputhje me nenin 38, nenin 36 dhe 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ne nenin 41 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“,i ndryshuar, rekomandimin e APP nr. 3341/1 prot, date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentat e

tenderit te procedurave te prokurimit publik”, rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr.145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise“, si dhe referuar Relacion per argumentimin e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike nr. 1124/7 prot., datë 24.05.2024 “Argumentimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me objekt: **Zhvendosja e pajisjes Kappa të prodhuesit Comercer/ose ekuivalent**”, për një periudhë 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës, për çmontimin dhe magazinimin e pajisjes në Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore në katin -1., dhe shkresa për plotësimin e informacionit me nr.1124/8 prot, date 19.06.2024, “**Zhvendosja e pajisjes Kappa të prodhuesit Comercer/ose ekuivalent**” për një periudhë 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës, për çmontimin dhe magazinimin e Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore në katin -1, me Urdhër të Titullarit të Përgjithshëm me nr. 192 (nr. 1124/2 prot) datë 10.05.2024, bashkelidhur kërkesës “Për hapje procedure” nr. 1124/9 prot., datë 01.07.2024 të Drejtorisë së IT dhe Inxhinierise Klinike.

- Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të parashikimeve të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi për specifikimet teknike.

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Zhvendosja e pajisjes Kappa të prodhuesit Comercer/ose ekuivalent”.

Nr.	Produkti	Sasia
1	Cinstalimit,zhvendosja dhe riinstalimit i pajisjes Kappa të prodhuesit Comercer, model FHG LAF	1

Specifikimet e Përgjithshme

1. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë që ka të paktën 1(një)* Inxhinierë/Specialistë në stafin e vet të trajnuar për pajisje mjekësore, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës.
2. Kompania e autorizuar duhet të jetë e çertifikuar me ISO 9001: 2015 të vlefshme.
3. Kompania duhet të jetë e autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë për pajisjet mjekësore.

Specifikimet teknike të veçanta:

Zhvendosja e kappës radiokimike nga ish ambientet e Spitalit të Semundjeve të Brendshme në katin 0 në ambintet e Spitalit Qëndror në Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësive Bërthamore në katin -1.

Modeli I pajisjes: FHG LAF

Tipi: 4C1F

SN: 40C1F/0111/V11288

C’instalimi,zhvendosja dhe instalimit i pajisjeve brenda ndërtesave për të zhvendosur KAPEN nga laboratorit ekzistues në atë përfundimtar.


Pajisja do të instalohet në ambientin e përcaktuar sipas projektit në Spitalin Qëndror në QSUNT dhe do ti vihet në dispozicion Operatori Ekonomik të shpallur fitues.

- Transporti nga njëri vend në tjetrin
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë pajisjet e nevojshme për të mundësuar zhvendosjen e pajisjes
- Paleta dhe kuti druri për paketim dhe materiale mbrojtëse.
- Testi i rrjedhjes dhe lidhja me sistemin e aspirimit të përcaktuar.
- Te marre masa për materiale të nevojshme për të mbrojtur dyshtemenë përgjatë rrugës së kalimit gjatë montimit;
- Përfundim të dyshtemesë përgjatë kalimit nëse është e nevojshme.
- Te këto materiale dhe mjete për pastrimin e Kapës (tretës, solucione, veshje të posaçme etj.)
- Te kryje kontrollin funksional përpara zhvendosjes.
- Te kryje kontrollin funksional pas instalimit.
- Pjesët e këmbimit nuk mund të kuotohen veçmas pas kontrollit funksional nëse është e nevojshme.
- Operatori ekonomik pas instalimit duhet të kryej testet e nevojshme të pajisjes.
- Zëvendësimi ose riparimi i komponentëve të ndryshëm të pajisjes nëse nuk kalon testet funksionale.
- Te kryje testet dhe kalibrimet për shpejtësinë e ajrit dhe testin e drejtimit të ajrit
 - TESTET e shpejtësisë së rrjedhjes laminare
 - TESTET e rrjedhjes me një drejtim (testi i tymit)
 - TESTET e integritetit të filtrave


Ne rast se do këto nevojë për heqjen e dyerve të plumbuara dhe hapje të mureve të plumbuara në ambientin e ri të laboratorit ku do të instalohet. Operatori duhet të marrë parasysh që është përgjegjësi e tij riparimi i mureve dhe dyerve me të njëjtën trashësi mbrojtëse ndaj rrezatimit jonizues dhe rivendosja e dyerve në gjendje funksionale.

Ambienti aktual ku ndodhet pajisja

PLAN KATI -1



Ambienti ku do të instalohet në Spitalin Qëndror



Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e QSUNT, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura te punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

Ofertuesi (Operatori Ekonomik) merr përsipër riparimin e ambienteve në rast dëmtimi gjatë transportit si dhe gjatë punimeve.

Shtojca 6

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Punimet do të kryhen në Në Spitali Qëndror në QSU “Nënë Tereza”, Tiranë.

Specifikimet teknike të veçanta:

Zhvendosja e kappës radiokimike nga ish ambientet e Spitalit të Semundjeve të Brendshme në katin 0 në ambientet e Spitalit Qëndror në Shërbimin e Imazherisë dhe Mjekësisë Bërthamore në katin -1.

Modeli I pajisjes: FHG LAF

Tipi: 4C1F

SN: 40C1F/0111/V11288

C’instalimi, zhvendosja dhe instalimit i pajisjeve brenda ndërtesave për të zhvendosur KAPEN nga laborator ekzistues në atë përfundimtar.

Pajisja do të instalohet në ambientin e përcaktuar sipas projektit në Spitalin Qëndror në QSUNT dhe do ti vihet në dispozicion Operatori Ekonomik të shpallur fitues.

- Transporti nga njëri vend në tjetrin
- Operatori ekonomik duhet të sigurojë pajisjet e nevojshme për të mundësuar zhvendosjen e pajisjes
- Paleta dhe kuti druri për paketim dhe materiale mbrojtëse.
- Testi i rrjedhjes dhe lidhja me sistemin e aspirimit të përcaktuar.
- Te marre masa për materiale të nevojshme për të mbrojtur dyshehtësinë përgjatë rruges së kalimit gjatë montimit;
- Përforsim të dyshehtësinë përgjatë kalimit nëse është e nevojshme.
- Te kete materiale dhe mjete për pastrimin e Kapes (tretës, solucione, veshje të posaçme etj.)
- Te kryje kontrollin funksional përpara zhvendosjes.
- Te kryje kontrollin funksional pas instalimit.
- Pjesët e këmbimit nuk mund të kuotohen veçmas pas kontrollit funksional nëse është e nevojshme.
- Operatori ekonomik pas instalimit duhet të kryej testet e nevojshme të pajisjes.
- Zëvendësimi ose riparimi i komponentëve të ndryshëm të pajisjes nëse nuk kalon testet funksionale.
- Te kryje testet dhe kalibrimet për shpejtësinë e ajrit dhe testin e drejtimit të ajrit
- TESTET e shpejtësisë së rrjedhjes laminare
- TESTET e rrjedhjes me një drejtim (testi i tymit)
- TESTET e integritetit të filtrave

Ne rast se do kete nevojë për heqjen e dyerve të plumbuara dhe hapje të mureve të plumbuara në ambientin e ri të laboratorit ku do të instalohet. Operatori duhet të marrë parasysh që është

perjegjesi e tij riparimi I mureve dhe dyerve me të njëjtën trashësi mbrojtëse ndaj rrezatimit jonizues dhe rivendosja e dyerve ne gjendje funksionale.

Afati i lëvrimit të shërbimit: Brenda 10 (dhjetë) ditë nga lidhja e kontratës.